

**AKT THEMELIMI**  
**I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar**

**3C CONSULTING**

Sot, më datë 04.07.2024, personalisht:

- Znj. Laura Comito, atësia Bruno, amësia Speziale Antonia, shtetase italiane, lindur ne Giaveno (TO) më 06.06.1977 dhe banues Val Della Torre (TO) Via Trucco Rossato n.82 Itali, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilës u garantova me Leternjoftim ID Nr. CA45490NQ, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare.
- Z.Marco Matteo Cadeddu, atësia Salvatore, amësia Franca, shtetas italian, lindur në Torino (TO) më 27.10.1976 dhe banues Val Della Torre, 29- Pianezza (TO), Itali, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Nr. CA55494NR, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare.
- Z. Alfredo Croce, atësia Luigi, amësia Alba, shtetas italian, lindur në Avezzano më 24.05.1971 dhe banues në Via Liguria 19/C, Itali, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID Nr. AZ1892533, me cilësinë e ortakut të shoqërisë tregtare.

Përpilojne këte akt themelimi të shoqërisë tregtare **3C CONSULTING sh.p.k**, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themelojnë Shoqërinë Tregtare 3C CONSULTING SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri 3C CONSULTING SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë thellësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit 3C CONSULTING SH.P.K dhe me emrin tregtar 3C CONSULTING shpk. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.



#### **NENI 4 Objekti i veprimtarisë**

Konsulencë e përgjithshme për kompani dhe individë, shërbime burokratike me organe publike dhe private për qytetarët, mbështetje teknike nëpërmjet profesionistëve për kompani dhe individë. Konsulencë kombëtare dhe ndërkombëtare, bashkëpunim me klientë që i përkasin të gjithë sektorëve dhe në çdo pjesë të botës për të identifikuar mundësitë më të mira për të adresuar sfidat më kritike dhe transformimin e biznesit të tyre. Bashkëpunimin me zyrat e pranishme në çdo pjesë të botës, krijimin e avantazheve konkurruese nëpërmjet zgjidhjeve unike, forcimin e aftësive dhe zbatimin e ndryshimeve.

Ofrimin e mundësive të larmishme të rritjes profesionale, bashkëpunimin dhe partneritetin për zgjedhjet dhe transformimin e aktiviteteve të kompanive në përgjithësi.

Konsulencë strategjike, analiza e nevojave, planifikimi dhe menaxhimi i projektit, vlerësimi i fizibilitetit të projektit, analiza e ndikimit mjedisor dhe social, menaxhimi i burimeve njerëzore dhe financiare, asistencë në kërkimin e financimit (identifikimi i mundësive) përgatitja e projekt propozimeve, mbështetje në negociata me institucionet financuese.

Mbështetje në tranzicionin nga projektet tradicionale në qasje më të qëndrueshme, zbatimi i strategjive për menaxhimin e ndryshimeve, shërbime të strukturuar financiare si start up, projekte të kompanive, private dhe publike, fatura të pambledhura.

Pasuri të paluajtshme, projekte transformimi në hotele B&B, mallra të pashitura, siguri dhe logjistikë, logjistikë globale, operacione emergjente, kontraktime dhe menaxhim objektesh.

#### **NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Myrtezim KELLICI, Pl. Al-FAM, Nr. 23 Tirane.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhë kohore pa afat.

#### **NENI 6 Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është 100.000 (njqind mije ) Lek dhe zotërohet nga ortakët themelues.

Vlera totale e kapitalit të regjistruar: 100.000 leke


Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 3

Kapitali themeltar është mbuluar tërësisht nga ortakët themelues.

#### **NENI 7**

Ortakët themelues të Shoqërisë Tregtare 3C Consulting SH.P.K zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:



- Laura Comito, pjesemarrja me përqindje 33 %, 1 kuote, lloji i kontributit në para 33.000 leke.
- Marco Matteo Cadeddu, pjesemarrja me përqindje 34 %, 1 kuote, lloji i kontributit në para 34.000 leke.
- Alfredo Croce pjesemarrja me përqindje 33 %, 1 kuote, lloji i kontributit në para 33.000 leke

## **NENI 8 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Ortakeve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/et – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## **NENI 9 Administratori**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Z. Marco Matteo Cadeddu

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili i ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## **NENI 10**

Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## **NENI 11**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

## **NENI 12**

Mosmarrvëshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

## **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimi hartohet në gjuhën shqipe.

### **ORTAKET THEMELUES**

**Laura Comito**

**Marco Matteo Cadeddu**

**Alfredo Croce**